

## REPUBLIKA E KOSOVËS

## KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### Iu fton


Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **29 tetor 2020 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Qendrës Rinore “Naxhije dhe Fahri Buçinca” në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 24 shtator 2020;
2. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Dhënien e Dekoratave në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi i dytë**);
3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijët (**shqyrtimi i parë**);
4. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë komunale për komunikim 2021 – 2023 (**shqyrtimi i parë**);
5. Shqyrtimi i Udhëzuesit të përgjithshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve - Draft-Planit të pjesëmarrjes qytetare –në nivel lokal (**shqyrtimi i dytë**);
6. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2019 të KRM “Uniteti” Sh. A. Mitrovicë;
7. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;
9. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 dhe përgatitjen për fillimin e vitit shkollor 2020/2021;
10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me dhënien në shfrytëzim të tokave bujqësore;
11. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në DKRS;
12. Të ndryshme.

*Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë rekomandimet e KPF-së dhe materialet për pikat e rendit të ditës.*

Nasuf Aliu  
  
Kryesues i Kuvendit

